Kronikë

2 operacione anti-drogë në Tiranë! Kanabis në formë çokollate e heroinë në periferi, trafikantët i 'stampojnë' gamilen sipër! 3 të arrestuar, mes tyre babë e bir

Dy operacione anti-drogë janë finalizuar këtë të martë në Tiranë, duke cuar në pranga 3 persona. Në operacionin e parë, janë arrestuar babë e bir, Sami dhe Kevin Qordja, 43 dhe19 vjeç, të cilëve i janë gjetur në banesë 48.5 kilogramë kanabis, e cila ishte ndarë në formën e çokollatës në 160 pako.

HOROSKOPI

Redaksia
26 Prill, 19:37 | Përditësimi i fundit: 26 Prill, 20:32

TIRANË- Dy operacione anti-drogë janë finalizuar këtë të martë në Tiranë, duke çuar në pranga 3 persona. Në operacionin e parë, janë arrestuar babë e bir, Sami dhe Kevin Qordja, 43 dhe19 vjeç, të cilëve u janë gjetur në banesë 48.5 kilogramë kanabis, e cila ishte ndarë në formën e çokollatës në 160 pako. Siç shihet edhe në foto, sipër pakove me drogë, është stampuar gamilja. Babë e bir përpunonin kanabisin dhe më pas e shisnin në zona të ndryshme të Tiranës. Gjithashtu, ku gjet në banesë edhe një armë gjahu pa leje, 1 makinë dhe 2 celular.

Më pas hetimet kanë vijuar, duke finalizuar operacionin e dytë anti-drogë, ku në pranga ra Ramazan Qordja, 31-vjeç. Nuk është e qartë lidhja që ai ka me të arrestuarit në operacionin e parë, por siç bëri me dije Lorenc Panganika, drejtori i Policisë së Tiranës në konferencën për shtyp, Ramazan Qordja, merrej me shitjen e heroinës në doza. Ai i shiste ato në zonën e Tufinës, në Babrru dhe në rrugën "Myslym Keta". Bëhet fjalë për sasi 1-2 kg heroine, të cilën e ndante më pas dhe e shiste në bashkëpunim me persona të tjerë. Edhe 31-vjeçarit, gjatë kontrollit, iu gjet në banesë 312 gramë heroinë, një armë gjahu, peshore elektronike dhe një celular.

LEXO EDHE:
Elizabeta Imeraj rrëfehet para KPA: Unë mora në dorë dosjen 'Shullazi' pasi 10 prokurorë u tërhoqën nga frika e tritolit nën derë, kam hetuar pushtetarë dhe terroristë, ankimi ndaj meje i sajuar

Ia vlen për t'u theksuar që në këtë konferencë, krah drejtorit të policisë së kryeqytetit, ishte edhe drejtuesja e Prokurorisë së Tiranës, ***Elisabeta Imeraj***. Kjo e fundit, do të mësojë nesër në orën 15:00 fatin e saj në sistemin e drejtësisë, nëse do të shkarkohet siç Komisioneri Publik e kërkon, apo nëse KPA do të lërë në fuqi vendimin e KPK për të vijuar detyrën.





Droga e sekuestruar

B.K./Shqiptarja.com

TAG: operacion antidrogë | elisabeta imeraj | Ramazan Qordja | Lorenc Panganika | sami qordja | kevin qordja

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Si e vlerësoni qëndrimin e ambasadores Kim në çështjet e politikat e brendshme të vendit?

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Kronikë



Trafik droge drejt Greqisë, policia arreston 3 persona me 40 kilogramë kanabis! Operacioni 'Restart' në Korçë, shkon në 19 numri i të arrestuarve dhe në 485 kg droga e kapur

21 Prill, 11:30

Kronikë



KPA 6 orë seancë për kryeprokuroren e Tiranës! Elisabeta Imeraj-Komisioneriti Publik: Paraqiti si provë dokument pronësie fals! Vendimi përfundimtar në 27 prill

Arsen Rusta

20 Prill, 13:56

Kronikë



KPA pranon kërkesën e Elisabeta Imeraj për të marrë në shqyrtim provat e reja, konkluzionet përfundimtare më 20 prill! Prokuroria: Pres drejtësi

Arsen Rusta

12 Prill, 13:14

Kronikë



'Një maloke më pak', qytetarët protestë para organeve të vetting-ut për fyerjen ndaj Elisabeta Imerajt! Aktori Mehdi Malkaj: Kush e solli ndarjen veri-jug? Shqipëria është një

8 Prill, 14:29

Kronikë



Faza e 6-të e operacionit 'Restart' në Korçë, prangosen 4 persona, sekuestrohen 72 kg kanabis! Shkon në 16 numri i të arrestuarve dhe në 445 kg droga e kapur (VIDEO)

8 Prill, 08:47

Kronikë



Zbulohen 10 sera për kultivim kanabisi në Thumanë, sekuestrohen 925 fidanë! 2 të arrestuar, 1 në kërkim

7 Prill, 08:49

Kronikë



Gjyqi 3-ditor për Elisabeta Imerajn, ballafaqimi i fakteve për pasurinë dhe figurën, intriga, një histori bullizmi dhe dyshime për 'komplot'! KPA vendim në 12 prill

Adriatik Doci

1 Prill, 17:29

Kronikë



Skandali/ Si përdori Theo Jacobs denoncimin e një gruaje të sëmurë mendore si provë për ankiminin e vendimit të KPK dhe denoncim në SPAK kundër prokurores Imeraj

30 Mars, 16:23

Kronikë



Shtyhet për nesër në 12:30 seanca në KPA për Elisabeta Imerajn! Drejtuesja e prokurorisë së Tiranës kërkon konfirmim në detyrë: Ankimimi i ONM erdhi nga denoncime të memë, një prej denoncuesve nuk ekziston

Arsen Rusta

30 Mars, 11:45

Kronikë



Zbulohet një 'shtëpi bari' në zonën e Ndroqit, shoqërohen dy punonjës të OSHEE! Kontrolle të imtësishme në ambiente të mbyllura! Aksioni i policisë me urdhër të Gledis Nanos

Sokol Dema

11 Shkurt, 14:28

Kronikë



Kryepolici Nano mbyll turin e analizës së 2021 në Tiranë! Vrasja në Astir, Don Bosko e Kodër-Kamëz, ende pa autor

Sokol Dema

27 Janar, 18:43

Politikë



Lulzim Basha kërkon ndihmë: Të ndërhyhet për të shmangur viktimat nga dhuna e Berishës, deputetët në rrezik!

Policia shpërndan protestuesit: Godina e selisë skenë krimi

8 Janar, 12:54

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i pasaktorizuar i kesaj faqeje